



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 16.12.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 11.12.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "NNT"ALFA I' për aktivitetin: "Implementimi i Planit të Mobilitetit-Rekonstruimi i rruges "Muharrem Fejza" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-6248-511 nxjerr:

### VENDIM

1. Pranohet pjesërisht kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "NNT ALFA I" e datës 11.12.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Implementimi i Planit të Mobilitetit-Rekonstruimi i rruges "Muharrem Fejza" me Nr.616 10 6248 511 kundër Njoftimit për dhënje të kontratës te AK –së, të datës 06.12.2019, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Anullohet Vendimi për dhënje të kontratës i publikuar me datë: 06.12.2019;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që te aktivitetin ta kthej ne rivlerësim.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### Arsyetim

Operatori Ekonomik "NNT ALFA I " me datë 05.11.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Implementimi i Planit të Mobilitetit-Rekonstruimi i rruges "Muharrem Fejza" me numër të prokurimit 616 19 6284 511.

Autoriteti Kontraktues, me datë 16.12.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkeses për rishqyrtim:

1. Lidhur me pikën 1 se keni marreveshje bashkepunimi me OE-ik "Eskavatori SHPK" ju sqaroj se nuk është kontestuar marreveshja, por është kontestuar mjeti i punës, i cili sipas Deklaratës Unike Doganore është dërguar jashtë shtetit. Pretendimet tuaja se kemi të bëjmë me të njëjtin OE-ik dhe se "Eskavatori MK" është prone e "Eskavatorit SHPK" janë plotësisht të pa bazuara, pasi që kemi të bëjmë me OE-ik që janë në dy

shtete te ndryshme dhe "Eskavatori SHPK" mund te jete vetem themeluesi i OE-ik "Eskavatori MK" e kurrsesi nuk kemi te bejme me OE-ik te njejte, pasi qe i dyti eshte i regjistruar dhe vepron ne nje shtet tjetet. Nga deshmia e dorezuar me tender rrjedh se ju keni dorezuar deshmi se mjete nuk eshte ne Kosove, ndersa deshmia se eshte kthyer ne Kosove poashtu nuk tregon asgje pasi qe dokumenti doganor nuk precizon a eshte kompania "Eskavatori SHPK" derguesi, eksportuesi apo marresi pasi qe nuk figuron emri i OE-ik nga Maqedonia "Eskavatori MK. Pra pretendimi se ju keni mareevshje te pranueshme nuk qendron pasi qe deshmite per mjete e cekur tregojne se i njeiti nuk mund te jete objekt i marreveshjes;

2. Lidhur me pretendimin se OE-ik "Rexha Shpk" i eshte kerkuar sqarim per automjetin per largim te bores eshte pjeserisht i bazuar, pasi qe kjo ka ndodhur me fajin e komisionit, i cili ka konstatuar se i njeiti ka dorezuar dy automjete per pastrimin e rrugeve dhe te njejtit i eshte kerkuar qe te ofroj deshmi valide (libreze qarkullimi) per njerin prej tyre. OE-ik "Rexha SHPK" ka dorezuar deshmi per njerin nga automjetet e kerkuara (targat 01-843-JC dhe 01-269-GI), respektivisht per automjetin e pare, i cili realisht eshte mjete per pastrim te bores, por kjo nuk eshte vleresuar si duhet nga komisioni. Gabimi i komisionit qendron ne faktin se eshte dashte te kerkohet sqarim per automjetin tjetet me targa 01-269-GI, i cili ne listen e paisjeve te dorezuar ne tender eshte paarqitur si automjet cisterne dhe ne librezin e qarkullimit eshte shenuar poashtu si i tille. Nga kjo rrjedh se kjo mangesi rrjedh nga komisioni dhe nuk ka te bej me pa pergjegjesine e tenderuesit, e cila eshte dashte te verifikohet nepermes kerkeses adekuate per sqarime. Ky verifikim duhet te behet ne procesin e rivleresimit.

3. Lidhur me pretendimin se i propozuari per kontrate nuk ploteson kerkesat teknike, respektivisht se nuk ka dy teknik sipas kerkesave nga pika 9.1 dhe 9.2 e FDT-se eshte e pa qendrueshme, pasi qe i njeiti ka dorezuar deshmi per tre teknik: nga stafi kyç Isuf Demolli dhe Burim Hasanaj (bachelor por i angazhuar ne rolin e teknikut) dhe nga stafi tjetet Zejnullah Dragusha, teknik i ndertimtarise, per te cilin mungon diploma, por ka kontrate, per te cilin poashtu duhet ti kerkohet deshmi ne procesin e rivleresimit.

2. Lidhur me pretendimet tjera per marreveshjet qe kane te bejne me vitin 2019 e duhet te jene per vitin 2020 ju sqarojme se ky pretendim eshte ne kundertshtim edhe me marreveshjet tuaja, pasi qe edhe ato kane te bejne me vitin 2019.

Bazuar në konstatimet paraprake konkludojmë se aktiviteti duhet te kthehet ne rivleresim dhe anetaret e komisionit te rivleresimit duhet te ekzaminojne me kujdes dhe ne harmoni me dispozitatat ligjore te gjitha tenderet e dorezuar e posaçerisht pikat qe kene te bejne me pretendimet e parashtruesit te kerkeses dhe rekomandimet e dhena per sqarime te metejme nga zyrtari pergjegjes.

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit